

19/06/03

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration
Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca Plenare
Seanca nr.2003/18
Prishtinë,më 19 qershor 2003,në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit,salla plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Fatmir Sejdiu,anëtar i Kryesisë.
Kryesusi konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 91 deputetë dhe shpalli të hapur punën e saj.

Në seancën e mëparshme ishte miratuar rendi i ditës i kësaj seance,si vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
2. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për produktet dhe pajisjet medicinale-3003/17;
3. Shqyrtimi i raportit për gjendjen në Koorporatën Energjetike të Kosovës;
4. Parashtrimi i pyetjeve dhe
5. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare që duhet të mbahet më 26 qershor 2003.

Kryesuesi propozoi që pika e dytë e rendit të ditës,të shtyhet për seancën e ardhshme,ngase mungonte ministri i shëndetësisë që duhej ta arsyetonte P/ligjin para deputetëve.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme.

Nuk pati vërejtje në procesverbalin e seancës së mëparshme dhe ai u miratua.

2. Shqyrtimi i Raportit për gjendjen në Korporatën Energjetike të Kosovës.

Kryesuesi e ftoi kryetarin e Komisionit për Tregti dhe Industri që të paraqes raportin lidhur me këtë çështje.

Bajrush Xhemajli:- Kuvendi i Kosovës e ka ngarkuar Komisionin për Tregti dhe Industri që ta hulumtojë gjendjen në Korporatën Energjetike të Kosovës dhe të paraqes raport për këtë çështje.

Komisioni formoi grupin e punës prej pesë anëtarësh i cili gjatë hulumtimit të gjendjes në KEK ka zhvilluar biseda të drejtëpërdrejta me udhëheqësin e KEK-ut dhe shfrytëzoi raportet, analizat dhe informata e tyre.

Vizitoi minieren e Mihjes Sipërfaqësore të Mireshit dhe të Bardhit, ka shfrytëzuar materialet nga Ministria për Shërbime Publike, Ministria për Tregti dhe Industri, Oda Ekonomike e Kosovës si dhe Sindikata e Pavarur Energjetike të Kosovës, në bazë të së cilave hartoi këtë raport.

Problemet e mëdha që e ngarkojnë gjendjen në KEK janë të natyrës objektive dhe subjektive.

Problemet objektive janë trashiguar kryesisht nga dëmet që i ka bërë egërsira e pushtuesit: Eksplati është bërë duke mos i respektuar rregullat për mihjen e djerrinës; Stabilimentet nuk janë mirëmbajtur si duhet; Kapacitetet e KEK-ut janë shfrytëzuar në mënyrë të pamëshirshme për prodhimin e energjisë elektrike, pa marrë parasysh nevojat për një prodhim stabil dhe të rregullë.

Kapacitetet e termocentraleve janë 1.478 megavat, por ato nuk mund të shfrytëzohen as përafërsisht për shkak të amortizimit tejet të madh të stabilimenteve të tyre, sidomos në termocentralin "Kosova A" që njëherit është ndotësi më i madh i ambientit.

Problemet subjektive: Faktori njeri është ai i cili ka bërë që KEK-u të jetë në këtë gjendje të rëndë.

KEK-u ende nuk e ka të rregulluar statusin e vetë juridik, gjë që e pengon funksionin normal të tij. KEK-u aktualisht mbikqyret nga z. Stejner; nga përfaqësuesi i shtyllës së katërt të UNMIK-ut; nga këshilli mbikqyrës i KEK-ut; dhe nga përfaqësuesi i AKM-së.

Rezultatet e KEK-ut janë tejet të dobëta ngase organet menaxhuese nuk i harmonizojnë aktivitetet e tyre.

Stafi menaxhues vendor nuk ka çasje në investimet në KEK, kurse stafi ndërkombëtar thotë se në KEK janë investuar rreth 500 milion dollarë, por pas regjistrimit të mjeteve themelore të investuara në KEK është konstatuar se vetëm një e treta e mjeteve është investuar.

Gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar nuk është realizuar asnjë remont i mirfilltë.

Intervencimet në blloqet e termocentraleve janë bërë ad hoc, vetëm pas prishjeve që kanë qenë të shpeshta. Gjendjen e ka keqësuar sidomos djegëja e bllokut B1 pas goditjes së rufesë në KEK. Është shqetësuese mospërgjegjësia pas gjithë atyre ndodhive. Sipas